

## **POLITIKA E PRIVATËSISË**

### **SI I PËRDORIM NE TË DHËNAT TUAJA PERSONALE**

Në website-in e Bankës “CREDINS”, [www.bankacredins.com](http://www.bankacredins.com), në disa rubrika si aplikimet për Punë, rubrika “Karriera”, rubrika “Na Kontaktoni”, rubrika “Credins Online”, “aplikimi juaj per Kredi”, “Prona ne Shitje” dhe “Newsletter” kërkohet nga përdoruesi që të plotësohen disa nga të dhënat personale. Banka Credins në këtë kuadër, mbledhë të dhënat tuaja personale. Kjo vlen për informacionin e mbledhur në lidhje me vizitorët në faqen tone, klientët, kandidatët për punësim dhe punonjësit tanë të tanishëm si dhe ish-punonjësit, individët e tjerë të cilët paraqesin kërkesa të ndryshme për marrje informacioni, dhënie konsulence, aplikime etj.

Banka garanton sistem të lartë sigurie për ruajtjen dhe përpunimin e mëtejshëm të këtyre të dhënave, në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 9887 date 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Përdoruesi konfirmon plotësimin dhe vërtetësinë e informacionit të dhënë dhe deklaron gjithashtu se ka plotësuar në mënyrë korrekte dhe të vërtete të gjithë informacionin e kërkuar.

Gjithashtu, me plotësimin online, përdoruesi deklaron se jep pelqimin e tij për procedimin e mëtejshëm të informacionit të dhënë për përdorim të brëndshëm të Bankës.

Në këtë faqe përshkruhen mjetet e administrimit të kësaj faqe internet në lidhje me trajtimin e informacionit dhe të dhënave personale të përdoruesve që vizitojnë këtë faqe interneti. Informacioni në këtë pikë u paraqitet në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, individëve që përdorin shërbimet e bankës të ofruara nëpërmjet internetit, të arritshme në faqen e internetit që përkon me faqen kryesore të adresës zyrtare të internetit të bankës.

Të dhënat jepen vetëm për faqen dhe jo për faqe të tjera të cilat vizitohen nga përdoruesi nëpërmjet lidhjeve të tjera.

Pala përgjegjëse për trajtimin e të dhënave personale është “Banka CREDINS” Sh.a me seli qendrore në Rr. “Vaso Pasha”, Nr.8, Tiranë, Shqipëri.

### **PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE**

Përpunimi i të dhënave personale në lidhje me shërbimet që ofrohen nëpërmjet internetit nga kjo faqe menaxhohet nga stafi teknik i zyrës përgjegjëse për përpunimin e të dhënave. Asnjë informacion që rezulton nga shërbimi nëpërmjet internetit nuk komunikohet ose shpërndahet përveç rasteve kur informacioni kërkohet nga organet kompetente që e fitojnë këtë të drejtë me ligj të veçantë duke respektuar kërkesat e ligjit.

Të dhënat personale që japin përdoruesit, përdoren vetëm për qëllimin e ofrimit të shërbimit ose për plotësimin e kërkesës dhe i komunikohen ofruesit të shërbimit dhe palëve të treta, vetëm nëse nevojiten për këtë qëllim, duke respektuar kërkesat e ligjit.

Punonjësit e Bankës i nënshtrohen detyrimit për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit i cili i jepet këtij të fundit për të ushtruar funksionet e tij në bazë Ligjit, dhe mund t’ua përhapë

atë vetëm autoriteteve të ligjshme. Banka vlerëson integritetin e tyre përpara se ata të punësohen. Banka monitoron pajtueshmërinë e tyre mbi detyrimet e tyre në lidhje me sigurinë e informacionit.

## **KATEGORITE E SUBJEKTEVE TË TË DHËNAVE QË PËRPUNOHEN**

Ne përdorim të dhënat personale të kategorive të subjekteve të të dhënave personale (klientë, punëmarrës, kandidatë për punë, etj), dhe i mbajmë ato me qëllim që të ofrojmë shërbimin ndaj subjektit të të dhënave edhe për rastet e kërkuara nga ky i fundit për qëllime të tjera të lidhura ngushtë me të. Të dhëna për kërkime në faqen e internetit dhe procedurat për softuerin, përgjegjëse për funksionimin e kësaj faqe interneti marrin të dhëna në kuadrin e operimit të zakonshëm dhe vetëm për periudhën e lidhjes, transmetimi i të cilave ndodh gjatë përdorimit të protokolleve të komunikimit nëpërmjet internetit. Kjo faqe nuk përfshin lidhjet midis kësaj faqeje dhe faqeve të tjera. Ne ju inkurajojmë të lexoni deklaratat e privatësisë në faqet e tjera të internetit që ju vizitoni.

Të dhënat personale të shërbimeve elektronike bankare të kategorive të subjekteve të të dhënave ruhen në një sistem me standart të lartë sigurie. Banka përpunon të dhënat personale të përdoruesit dhe të personave të autorizuar ekskluzivisht për qëllim të përdorimit të shërbimeve elektronike bankare. Këto të dhëna nuk merren për të vendosur lidhje me palët e identifikuar, por sipas natyrës së tyre, nëpërmjet përpunimit ose lidhjes me informacionin dhe të dhënat e palëve të treta, ato mundësojnë identifikimin e përdoruesve.

Të dhënat që jepen me dëshirë nga përdoruesi, të gjitha email-et fakultative, eksplicite dhe të dërguara me dëshirë në adresat e specifikuar në këtë faqe interneti, përfshin marrjen në vijim të adresës së dërguesit që nevojitet për t'ju përgjigjur kërkesave si dhe për çdo të dhënë tjetër personale që përmban email-i. Banka garanton secilin përdorues se pas dorëzimit të informacionit dhe të dhënave në serverin e faqes së internetit të Bankës, zbatohet një sistem me standard të lartë sigurie për ruajtjen dhe përpunimin e mëtejshëm të këtyre të dhënave, në përputhje me kërkesat e parashikuara në Ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Përdorimi i të dhënave personale për të dërguar materiale reklamimi ose informacion komercial për shitjen e produkteve ose shërbimeve nga Banka kërkon pëlqimin paraprak të subjektit të të dhënave. Nëpërmjet përdorimit të aplikimit ju jepni pëlqimin tuaj në lidhje me përpunimin e mëtejshëm të të dhënave duke pasur mundësinë që nëpërmjet një linku të dedikuar të ç'rregjistroheni në rast se nuk keni dëshirë të informoheni me të.

Në faqen e internetit të bankës do të paraqiten ose prezantohen në mënyrë progresive përmbledhje specifike të cilat përgatiten për shërbime të veçanta që mund të kërkohen.

Për individet që aplikojnë për t'u punësuar pranë Bankës, ne përdorim informacionin e tyre për procesin e aplikimit dhe për të monitoruar statistikën e rekrutimit. Kur ne duam të përhapim të dhënat një pale të tretë, për shembull, kur ne duam të marrim një referencë, ose të marrim disa të dhëna nga institucione të tjera përkatëse, ne nuk e bëjmë këtë, pa i informuar subjektet e të dhënave më parë, vetëm nëse ky informacion është i kërkuar me ligj. Të dhënat personale në lidhje me aplikantët të cilët nuk fitojnë konkursin ruhen deri në përfundimin e afatit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, më pas shkatërrohen ose fshihen. Ne mbajmë informacion

të pa personalizuar për qëllime statistikore në lidhje me aplikantët, për të ndihmuar aktivitetet tona të rekrutimit, por asnjë aplikant nuk është i identifikueshëm nga këto të dhëna.

Për individet që janë të punësuar pranë Bankes, ne mbajmë të dhëna personale që janë të nevojshme vetëm për qëllimin e punësimit dhe jo më shumë. Këto të dhëna mbahen në vende të sigurta, në mënyre manuale si edhe në sisteme kompjuterike në përputhje me ligjin dhe rregullat tona të brëndshme. Kur një punonjës nuk është më në raporte pune me Banken, për të ne përgatisim një dosje në lidhje me periudhën gjatë së cilës ai ka qenë i punësuar. Të dhënat e përfshira në të mbahen të sigurta dhe përdoren vetëm për qëllime me rëndësi të drejtpërdrejta mbi punësimin e personit deri në përfundimin e afatit të përcaktuar me ligj dhe më pas të dhënat shkatërrohen.

## **MËNYRAT E PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE**

Të dhënat personale të subjekteve përpunohen në menyrë elektronike dhe manuale në përputhje të plotë me masat e sigurisë të përcaktuara në dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Banka mbron të dhënat në ambiente dhe sisteme të sigurta deri në përfundimin e afatit të përcaktuar në Udhëzimin Nr.20 date 03.08.2012 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "Mbi Përpunimin e të Dhënave në Sektorin Bankar" përveç rasteve kur legjislacioni ne fuqi e parashikon ndryshe, më pas të dhënat shkatërrohen.

## **AKSESI NË TË DHËNAT PERSONALE**

Banka CREDINS përpiqet të jetë sa më e hapur për t'i dhënë individëve akses në të dhënat e tyre personale. Individët mund të zbulojnë nëse ne mbajmë ndonjë të dhënë personale, duke na dërguar një "kërkesë për akses tek të dhënat personale" dhe në bazë të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar brenda një afati prej 30 ditësh nga data e marrjes së kërkesës banka ju informon mbi të dhënat ose ju shpjegojmë arsyen e mosdhënies së informacionit.

Nëse ne mbajmë të dhënat tuaja personale, ne do t'ju:

- Bëjmë me dije se përse ne i mbajmë ato;
- Tregojmë se te cili marrës mund ti përhapim këto të dhëna;
- Informojmë nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare;
- Japim një përshkrim të tyre dhe nëse është e mundur në një formë të kuptueshme kopje të informacionit.

Për çdo të dhënë personale që ne mund të mbajmë, si edhe mbi çdo të drejtë që ju në cilësinë e subjektit të të dhënave gëzoni në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar është e nevojshme të bëni një kërkesë pranë bankës duke dorëzuar dokumentet ligjor të identifikimit tuaj.

## **TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE PERSONALE**

Individët, të dhënat personale të të cilëve përpunohen, kanë të drejtë në bazë të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të marrin në çdo kohë konfirmimin për ekzistencën ose jo të të dhënave personale dhe të dinë përmbajtjen dhe burimin e tyre, të verifikojnë saktësinë, përditësimin ose korrigjimin, të kërkojnë informacion për qëllimin e përpunimit, për kategoritë e të dhënave personale të përpunuara, transformimin në mënyrë anonime ose bllokimin e informacionit dhe të dhënave që trajtohen në kundërshtim me ligjin, si dhe në çdo rast të kundërshtojnë, për arsye të ligjshme, trajtimin e tyre. Banka ju informon për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, si edhe mbi çdo të drejtë që ju në cilësinë e subjektit të të dhënave gëzoni në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

## **SIGURIA E TË DHËNAVE PERSONALE QË PËRPUNOHEN**

Banka përpunon të dhënat personale të kategorive të subjekteve të të dhënave personale me qëllim kryerjen e veprimtarisë së saj dhe detyrave të saj statutores në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullave të brendshme. Kjo mund të përfshijë edhe informacione konfidenciale për kategoritë e subjekteve të të dhënave që përpunohen. Informacioni është një aset i çmuar, prandaj duhet të ndërmerren hapa për të mbrojtur informacionin nga përdorimi i paautorizuar, ndryshimi, zbulimi apo shkatërrimi, qoftë aksidental ose i qëllimshëm. Banka është e angazhuar për të siguruar përdorimin e informacionit dhe informacionin e sistemeve të teknologjisë me qëllim ruajtjen e integritetit dhe konfidencialitetit të informacionit nën kontrollin e saj. Banka përdor një qasje të bazuar në risk, gjatë vlerësimit dhe të kuptuarit të rreziqeve si dhe përdor të gjitha mjetet fizike të personelit, teknike dhe procedurale për të arritur masat e duhura të sigurisë. Banka merr parasysh zhvillimet në teknologji dhe kostot e zbatimit për të arritur një nivel sigurie të përshtatshëm për natyrën e informacionit dhe të dëmit që mund të rezultojë nga një shkelje e mundshme e sigurisë mbi të dhënat personale. Të gjithë punonjësit e Bankës i nënshtrohen detyrimit për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit i cili i jepet atyre për të ushtruar funksionet e tyre në bazë të përkrahimit të punës, dhe mund t'ua përhapë atë vetëm autoriteteve të ligjshme. Banka vlerëson integritetin e tyre përpara se ata të punësohen. Banka monitoron pajtueshmërinë e tyre mbi detyrimet e tyre në lidhje me sigurinë e informacionit. Punonjësit e bankës sipas deklaratës së konfidencialitetit të nënshkruar prej tyre ku mbajnë përgjegjësi ligjore civile dhe penale, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin e informacionit edhe pas mbarimit të funksionit të tyre.

Nëpërmjet hyrjes në këtë faqe interneti, ju konfirmoni se keni lexuar dhe pranuar kushtet e përdorimit të parashikuara në të. Ky dokument duhet kuptuar në përputhje dhe me kushtet e punës së bankës dhe kushtet e përdorimit të kësaj faqe interneti dhe përbën "Politikën mbi Privatësinë" e cila do të jetë objekt e përditësimeve të mëtejshme.

## **SI TË NA KONTAKTONI**

Kërkesat për informacion në lidhje me politikën tonë të privatësisë mund të dërgohen me e-mail në adresën [info@bankacredins.com](mailto:info@bankacredins.com) si edhe të paraqiteni pranë sporteleve të Bankës "CREDINS" Sh.a.